

SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS**Forca Tokësore****Tabela .1**

Nr.	Pozicioni i punës	Struktura e interesuar/ Forca	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me dosje	Intervista	Fillimi	Mbarimi
1	Teknik I mesëm elektroaut	Rep. usht. nr.1040 në FT	Zall-Herr, Tiranë	E pacaktuar	Me dosje	Nuk aplikohet	06.09.2024	20.09.2024

Formulari nr.1

1. Pozicioni i punës: “Teknik I mesëm elektroaut” , me pozicion “CII” , në skuadren e mirëmbajtjes, toga logjistike, kompania e mbështetjes, në Repartin Ushtarak nr.1040, Zall-Herr, me kod vendndodhje A-045, kod grupi B, numër paragrafi 005, numër rendor 008, në Forcën Tokësore
2. Kodi i pozicionit: C2, (Civil II).
3. Reparti/Institucioni: Reparti ushtarak nr.1040, Zall-Herr.
4. Vendi: Tiranë
5. Paga: VKM nr.717 datë 23.06.2009 “Pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nënpunësve të disa institucioneve buxhetore”, i ndryshuar.
6. Lloji i kontratës së punës: E pacaktuar.
7. Data e fillimit të aplikimit: 06.09.2024
8. Data e mbylljes së aplikimit: 15.09.2024
9. Mënyra e aplikimit: Me dosje
10. Dokumentat e aplikimit: - Kërkesë. - Formularin e aplikimit. - Fotokopje të kartës së identitetit. - Diplomën e shkollës së mesme/parauniversitare, diplomën e shkollës së lartë të noterizuar ose në origjinal. - Fotokopje të lejes së drejtimit të automjetit. - Dëshmi profesioni nëse ka. - Çertifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja. - Raport mjekësor. - Fotografi me përmasa 4x6, 2-copë. - Dëshmi penaliteti. - Vërtetim nga gjykata. - Vërtetim nga Prokuroria. - Librezë pune. - Jetëshkrimin CV. - Formularin e vetëdeklarimit.
11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës: - Të ketë shtetësinë shqiptare. - Të jetë jo më pak se 18-vjeç. - Të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar.

- Të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kriterëve të miratuara.
- Të jetë i aftë për punë nga ana shëndetsore.
- Të mos jetë dënuar me burg me vendim gjykate të formës së prerë për kryerje të një krimi.
- Të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda një viti nga data e aplikimit.

12. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

- Grada/Titulli: Civil II, (C2).
- Arsimi: Të ketë kryer arsimin e mesëm të përgjithshëm.
- Kualifikimi: Të ketë përvojë pune dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme për vendin përkatës të punës sipas kriterëve të miratuara.
- Trajnimi: Të ketë kryer trajnime të ndryshme.
- Eksperienca në punë: Të ketë eksperiencë të mëparshme në fushën që mbulon.
- Gjuha e huaj: Nuk aplikohet
- Kërkesa të tjera specifike:
 - Të ketë kurse kualifikimi për specialitetin e kërkuar.
 - Të ketë eksperiencë të mëparshme në fushën që mbulon.
- Niveli i çertifikatës së sigurisë: -----.

13. Përshkrimi i punës:

Detyrat kryesore: “**Teknik I mesëm elektroaut**”, me pozicion “CII”, në skuadrën e mirëmbajtjes, toga logjistike, kompania e mbështetjes, në Repartin Ushtarak nr.1040, Zall-Herr, me kod vendndodhje A-045, kod grupi B, numër paragrafi 005, numër rendor 008, në Forcën Tokësore; kryen këto detyra dhe mban përgjegjësi:

- Kontribuan për ndjekjen e të gjitha aktiviteteve që lidhen me mirëmbajtjen dhe përdorimin e mjeteve të transportit dhe ndihmon komandantin e skuadrës për realizimin e detyrave.
- Të mirëmbaj dhe riparoj në mënyrë të vazhdueshme mjetet e transportit.
- Të bëjë identifikimin e defekteve dhe riparimin e tyre.
- Të jetë i gatshëm në çdo kohë për realizimin e detyrës funksionale.
- Të raportoj tek eprori i drejtëpërdrejt çdo parregullsi apo shkelje që ai konstaton nga kushdo dhe raportimin e ngjarjeve të jashtëzakonshme.
- Të ketë kryer detyra të ndryshme dhe të ketë eksperienc pune mbi 3 vjetë si elektroaut apo teknik mirëmbajtje mjeteve.
- Të jetë i trajnuar në kurse të ndryshme për fushën e riparimit të automjeteve dhe sistemeve elektrik të tyre.
- Të jetë i specializuar për elektroaut.
- Të ketë aftësi të mira komunikuese.
- Të ketë përfunduar arsimin e mesëm profesional apo të përgjithshëm.

Përgjegjësitë: Përgjigjet për zbatimin e rregullave gjatë riparimit të mjeteve.

Përgjigjet për mirëmbajtjen dhe riparimin e mjeteve të transportit.

Përgjigjet për zbatimin e detyrave të dhëna nga komandanti I skuadrës.

14. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një **komision vlerësimi** i përbërë nga 3-(tre) veta.

Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- Përzgjedhjen paraprake.
- Vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse.

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga komisioni i ngritur me urdhër në Komandën e Forcës Tokësore, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Komisioni, me mbylljen e aplikimeve, verifikon dokumentacionin e aplikantëve nëse ai është i plotë dhe i saktë si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcakton kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit.

Kandidatët njoftohen nëse janë përzgjedhur ose jo për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave të konkurimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- Vlerësimin e dokumentave të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës, të lidhura me fushën përkatëse).

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, kandidatët listohen sipas listë meritës. Pas listimit të 3-tre kandidatëve, i paraqitet autoriteteve kompetente një memo miratuese për përzgjedhjen e kandidatit më të përshtatshëm.

Me emërimin në pozicionin e punës, do të lidhet kontrata individuale e punës.